



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 14, pika 14.1 dhe 14.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), të nenit 32, pika 32.3 shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-455 të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2008, merr

**V E N D I M**

**PËR DHËNIEN E NGASTRËS KADASTRORE, NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM, QENDRËS PËR THEMELIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË (BCK)**

**Neni 1**

Jepet në shfrytëzim të përkohshëm pjesa e ngastrës kadastrore 1498/86 , fleta poseduese 3838 , me pronar Komuna e Prishtinës, në sipërfaqe prej 1 000 m<sup>2</sup>, për ngritjen e objektit për inkubator të biznesit.

**Neni 2**

E drejta e shfrytëzimit të tokës, e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, do të jetë për kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej 10 vjetësh, me mundësi vazhdimi.

**Neni 3**

Investitori, sipas këtij Vendimi, është i obliguar që të bëjë fillimin e punëve ndërtimore më së largu 6 muaj nga dita e marrjes së këtij Vendimi.

**Neni 4**

Ndërtesa dhe investimet tjera të bëra nga BCK-ja në tokën e dhënë në shfrytëzim, pas realizimit të programit për QTHBK (viti 2011), mbeten në pronësi të Komunës së Prishtinës dhe do të destinohen për qëllime të njëjta.

**Neni 5**

Mënyra e shfrytëzimit të tokës, sipas këtij Vendimi, do të rregullohet me kontratë të veçantë në mes të Komunës dhe shfrytëzuesit.

**Neni 6**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

**Neni 7**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 110-1905, më 29.12.2008**

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**Prof dr. Isa Mustafa**